

Unë e vlerësoj faktin që së fundi parlamenti vendosi të diskutojë për një qëndrim ndaj aktit më të rëndë, pas Luftës së Dytë Botërore, fillimit de facto të luftës së tretë nga diktatori gjakësor, nga një tiran, i cili i parë në retrospektivë, për shkak të arsenalit bërthamor, është edhe tirani më i rrezikshëm i të gjitha kohërave, pra Vladimir Putin. Lufta që ai i shpalli Ukrainës, sulmi, agresioni që ndërmori ndaj Ukrainës, filloi në vitin 2014 me pushtimin e Krimesë. Personalisht, në atë periudhë e kam denoncuar si akt të njëjtë me aktin e Hitlerit dhe të Brezhnjev, që pushtuan Çekosllovakinë, por ky akt, ky agresion nuk është një agresion thjesht ndaj një vendi të lirë e të pavarur, siç është Ukraina. E vërteta është se ky është një agresion ndaj çdo vendi të lirë dhe të pavarur; në këtë kontekst, është një agresion i lirisë së botës dhe diktatori i Kremlinit, i aftë shpirtërisht dhe moralisht të ndërmarrë çdo akt kundër kësaj të fundit, duhet trajtuar vetëm si i tillë. Në rezolutën, të cilën e keni paraqitur sot me konsensusin e të dyja grupeve, ku relatori tjetër gjë lexoi në fjalën e tij dhe krejt tjetër diskutoi në paraqitjen që bëri, nuk e shoh këtë dimension të rrezikshëm botëror të agresionit ndaj Ukrainës, ku jo vetëm janë shkelur të gjitha kartat dhe dokumentet ndërkombëtare, por ndaj këtij kombi është shkelur: memorandum i Budapestit, në të cilin Rusia është palë dhe zotohej se do të garantonte, në përputhje me Kartën e OKB-së, kufijtë e këtij vendi.

Ndaj, mendoj se rezoluta në këtë kontekst duket sikur të jetë shkruar nga një vend i Oqeanisë, i qeverisur nga autokratë, dhe jo nga një vend europian dhe në zemër të Europës. Elementi i dytë madhor në tablonë e këtyre zhvillimeve, e cila ndryshoi Europën dhe botën, ka qenë qëndresa heroike e qytetarëve ukrainas, e ushtrisë së saj dhe Presidentit të saj, Zelenski. Të shumtë ishin ata analistë, politologë etj., që parashikonin rënien për disa orë apo brenda një kohe shumë të shkurtër të Kievit, të Ukrainës, por kjo nuk ndodhi, sepse një popull vendosi të luftojë për vendin e tij; nuk ndodhi, sepse një president vendosi të qëndrojë dhe të nderojë flamurin e tij; nuk ndodhi, sepse qytetarët e këtij vendi rrokën armët, u shndërruan në luftëtarë. Ata luftojnë sot në Ukrainë për të gjithë Europën, për të gjithë botën e lirë. Mendoj se rezoluta duhet ta shprehë në terma më të qartë këtë dimension të ri të zhvillimit, këtë kontribut global të qëndresës së Ukrainës dhe të Presidentit të saj Zelenski. Rezoluta që paraqitet këtu, është deficitare edhe në një aspekt tjetër: cilido që njeh historinë e kontinentit, të paktën në tre shekujt e fundit ambicet e Rusisë kanë qenë këto dy më kryesoret: Adriatiku dhe Dardanelet. Pra, a mund të rrimë ne kaq pa zë, në një kohe kur ai agresion në Ukrainë synon edhe ndonjë vend tjetër përreth, por në distancë absolutisht nuk synon asnjë territor tjetër më shumë se detin Adriatik? Ju duhet të kuptoni që Rusia Adriatikon dhe Dardanelet me atë çmendurinë e saj perandorake i ka jetike për të shkurtuar rrugët dhe për të dominuar në Mesdhe. Thashë edhe më parë që është një rezolutë, e cila duket sikur të jetë e shkruar në një vend të Oqeanisë dhe jo në një nga vendet gjeostrategjike, më nevralgjike për ambicet ekspansioniste të perandorit pa të mbathura, që quhet sot terroristi nuklear, Vladimir Putin. Zotërinj deputetë, një çështje tjetër kryesore del këtu edhe qëndrimi ndaj “Ballkanit të hapur”.

Ne e kemi denoncuar në mënyrë të përsëritur që “Ballkani i hapur” është një nismë e multimiliarderit Xhorxh Sorros, i cili ndjek më së shumti politikën e tij të jashtme dhe është fund e krye në funksion të hegjemonizmit serb dhe të influencës ruse në rajon. Unë jam i bindur se njerëzit në tërësi janë habitur me qëndrimet e fundit të Vladimir Putinit. Është gabim të habiteni. Ai është një kriminel që vjen nga labirintet e krimit të shërbimit më kriminal të Europës dhe të botës, që është KGB-ja. Po kaq kriminel është edhe Aleksandër Vuçiç, i cili gjatë luftës në Bosnje dhe në Kosovë ishte një doktrinuar i gjenocidit që serbët kryen ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe ndaj boshnjakëve në Bosnje. Pritet që ai të jetë një

faktor paqeje dhe “Ballkani i hapur” të mos jetë në funksion të interesave të Serbisë dhe të Ruisë. Ky është gabim i madh shumë. Zotëria që iku dhe la këtu t-shirt-in e ka si vëlla, e ka xhan Vuçicin, ndaj edhe nuk ju lejon juve të thoni në rezolutën tuaj një fjalë të vetme për “Ballkanin e hapur”. Në qoftë se ne denoncojmë “Ballkanin e hapur”, në qoftë se ne denoncojmë demonstratat në Beograd në mbështetje të Ruisë dhe të agresionit, të gjenocidit, të krimeve kundër njerëzimi dhe të inafnticitit që Putini po realizon në Ukrainë, ne thjesht bëjmë detyrën tonë si njerëz të qytetëruar. Ne nuk po shpikim dhe nuk po nxisim skena të paqena, ato tronditën Europën dhe botën. Kjo është arsyeja që Parlamenti Europian vendosi një nen në rezolutën e tij, ku i kërkon Serbisë të distancohet nga Rusia. Unë e vlerësoj votimin e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, por nuk është absolutisht siguri për një njeri që ka kryer krime lufte. Të gjitha këto qëndrime kanë vetëm një shpjegim. (Zoti Berisha paraqet një video). Pra, ky është shpjegimi i të gjitha atyre që thashë.

Zonja Kryetare, unë e vlerësoj qëndrimin tuaj, korrigjimin, por i dënoj bashkërendimet vulgare, të padenja të kreut të “Meduzës” me Lul “bravën”, që të përjashtohen deputetët nga diskutimet. Këto janë akte të turpshme, që nuk duhet të ndodhin asnjëherë. Ne jemi kundërshtarë këtu, por jemi të detyruar të dëgjojmë njeri-tjetrin. Faleminderit!